



THIRRJA E BERLINIT PËR VEPRIM TRASHËGIMI KULTURORE PËR TË ARDHMEN E EUROPËS

PREAMBULA

Viti [European i Trashëgimisë Kulturore](#) 2018 shënon një kthesë për lëvizjen gjithnjë në rritje në Europë për trashëgiminë kulturore. Ne duhet të ndërtojmë mbi këtë vrull për të njohur dhe shpalosur fuqinë pozitive dhe kohezive të trashëgimisë tonë të përbashkët kulturore dhe vlerave për të ndërlidhur qytetarët dhe komunitetet e Europës, dhe për ti dhënë një kuptim më të thellë të gjithë projektit European. Koha për veprim është tani.

Kjo „Thirrje e Berlinit për Veprim” është prezantuar në [Samitin e Trashëgimisë Kulturore Europiane](#) më 22 Qershor 2018 në Berlin nga tre organizatat bashkë-organizuese, përkatësisht [EUROPA NOSTRA](#) – Zëri i Trashëgimisë Kulturore në Europë; Komiteti i Trashëgimisë Kulturore Gjermane (DNK) që vepron si koordinator kombëtar i Vitit European të Trashëgimisë Kulturore në Gjermani; dhe Fondacioni Prusian i Trashëgimisë Kulturore (SPK) me seli në Berlin.

Në kuadër të Vitit European të Trashëgimisë Kulturore (VETK), Samiti i Parë European i Trashëgimisë Kulturore i mbajtur më 18–24 Qershor 2018 në Berlin mbledhi sëbashku qytetarë të shumtë dhe organizata nga e gjithë Europa. Midis pjesëmarrësve ishin përfaqësues të institucioneve, shoqatave, fondacioneve dhe universiteteve, si dhe të komuniteteve dhe vendeve fetare, të gjithë që kanë të bëjnë me trashëgiminë kulturore; arkitektë, profesionistët e muzevet, konservatorët-restauruet, artizanë, artistë, pronarët privatë të shtëpive historike dhe vendeve të trashëgimisë, hulumtuesit dhe mësuesit; përfaqësues të autoriteteve publike ose institucioneve financiare; sipërmarrësit, historianët e artit, gazetarët, fotografët, studentët dhe vullnetarët e rinj; së bashku me Ministrat e Kulturës, Kryetarët e bashkive të qyteteve historike, anëtarët e Parlamenteve European, Kombëtare dhe Rajonale, përfaqësues të institucioneve të Bashkimit European, si dhe të Këshillit të Europës, UNESCO dhe ICCROM dhe shumë rrjete të trashëgimisë europiane.

Kjo „Thirrje e Berlinit për Veprim” është e frymëzuar dhe e legjitimuar nga ekspertiza, entuziazmi dhe angazhimi i të gjitha grave dhe burrave që kujdesen për trashëgiminë kulturore (të prekshme, të paprekshme dhe dixhitale) dhe që i kushtojnë ekspertizën, kohën dhe energjinë e tyre si profesionistë ose vullnetarë, për të siguruar transmetimin e kësaj trashëgimie brezave të ardhshëm. Vlera ekonomike e punës së tyre është e rëndësishme; vlera sociale dhe kulturore është jetike.

„Thirrja e Berlinit për Veprim” gjithashtu bazohet në kontributin dhe mbështetjen e [koordinatorëve kombëtarë e VETK](#), anëtarë të [Komitetit të Stakeholderave VETK](#), si dhe të anëtarëve të [Aleancës Europiane të Trashëgimisë 3.3](#).

Tani ftojmë të gjithë ata që kujdesen dhe angazhohen për të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen e Europës për të nënshkruar, mbështetur dhe shpërndarë gjerësisht këtë Thirrje të Berlinit për Veprim.

THIRRJA E BERLINIT PËR VEPRIM

NE, QYTETARËT, ORGANIZATAT DHE INSTITUCIONET E NËNSHKRUARA ... jemi gati të marrim përgjegjësinë tonë të përbashkët për të shpalosur fuqinë kohezive dhe potencialin e trashëgimisë tonë të përbashkët kulturore për të çuar përpara një Europë më paqësore, të begatë, gjithëpërfshirëse dhe të drejtë.

Sot, në këtë Vit European të Trashëgimisë Kulturore, ne kemi një mundësi unike për të ndikuar në debatin mbi të ardhmen e Europës. Të ballafaquar me kaq shumë sfida, madje edhe kërcënime, të vlerave thelbësore Europiane, ky debat nuk mund të bazohet ekskluzivisht në konsiderata politike, ekonomike apo të sigurisë. Ne duhet të „ndryshojmë tonin” e narativës për Europën. Ne duhet ta vendosim trashëgiminë tonë të përbashkët kulturore në vendin që meriton: në qendër të politikave dhe prioritetëve të Europës.

PSE? SEPSE ...

1. Trashëgimia jonë kulturore është ajo që na bën Europiane, pasi reflekton vlerat, kulturat, dhe kujtimet tona të përbashkëta. Prandaj, është mishërimi i vërtetë i sloganit „Unitetit në Diversitet” të Europës dhe na ndihmon t’i rezistojmë forcave përçarëse që janë një rrezik për shoqërinë tonë;
2. Trashëgimia jonë kulturore përmbledh shtresat e shumta të identitetit tonë – vendorë, rajonal, kombëtare dhe Europiane; këto shtresa janë të ndërlidhura dhe përforcojnë njëra tjetrën dhe ato vazhdimisht evoluojnë;
3. Trashëgimia jonë kulturore ushqen ndjenjën tonë të përkatësisë në një komunitet lokal dhe ndjenjën e bashkësisë dhe solidaritetit në Europë;
4. Trashëgimia jonë kulturore lidh gjeneratat duke reflektuar ndër-lëvizjet ndërkufitare të njerëzve dhe ideve gjatë shumë shekujve të historisë sonë të përbashkët. Prandaj, është baza për një dialog dhe ndërveprim të respektueshëm dhe pasurues brenda dhe midis bashkësive në Europë por edhe me kulturat e tjera të botës;
5. Trashëgimia jonë kulturore siguron një urë midis të kaluarës dhe të ardhmes sonë. Na lejon që të nxjerrim dhe ndërtojmë traditat tona kulturore dhe historinë, ndërkohë që na ndihmon edhe për të shëruar plagët dhe për të ndrequr thyerjet e së kaluarës. Njëkohësisht frymëzon vazhdimin e krijimtarisë dhe inovacionit. Prandaj, është burim i të mësuarit dhe frymëzimit të vazhdueshëm dhe një bazë për qytetari aktive dhe përgjegjëse;
6. Trashëgimia jonë kulturore është gjithashtu një nxitës kryesor për zhvillimin e qëndrueshëm dhe rritjen e kohezionit social, si dhe burimi i shumë vendeve të punës të dobishme në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë; dhe
7. Trashëgimia jonë kulturore sjell harmoninë dhe bukurinë në mjedisin tonë të jetesës, mjedis e krijuar nga njeriu dhe natyra, dhe kështu përmirëson mirëqenien dhe cilësinë e jetës.

Duke rikujtuar – në këtë vit që shënon 70 vjetorin e [Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut](#) – se e drejta për trashëgiminë kulturore është një e drejtë themelore e njeriut dhe duke riafirmuar – në këtë Vit European të Trashëgimisë Kulturore – angazhimin tonë ndaj parimeve të formuluara në një numër të madh i [dokumenteve të politikave relevante](#) tashmë të miratuara nga shumë organizata Europiane dhe ndërkombëtare, tani është koha për t’i përkthyer këto parime në një plan veprim efektiv me rezultate të prekshme për Europën dhe qytetarët e saj:

VEPRIMI 1 ZHVILLIMI I PLANT EUROPIAN TË VEPRIMIT PËR TRASHËGIMIN KULTURORE

Ne bëjmë thirrje për një Plan Veprimi European për Trashëgiminë Kulturore ambicioz si një trashëgimi e qëndrueshme e Vitit European të Trashëgimisë Kulturore. Ky Plan Veprimi i cili tashmë është shpallur në [Axhendën e Re Europiane për Kulturën](#) e miratuar, duhet përgatitur dhe të jetëssohet me përfshirjen e plotë dhe angazhimin e të gjithë aktorëve përkatës publikë dhe privatë, duke përfshirë shoqërinë civile. Ky plan gjithashtu duhet të jetë holistik dhe i ndërlidhur me agjendat dhe prioritetet e tjera të politikës kryesore të BE-së, plotësisht në përputhje me [konkluzionet e fundit të Këshillit të BE](#). Ne i referohemi objektivave dhe fushave të politikave të tilla si kohezioni social, zhvillimi rajonal, zhvillimi urban, zhvillimi rural, politikat mjedisore, detare dhe turistike, axhenda e qëndrueshmërisë dhe përgatitja ndaj ndryshimeve klimaterike, hulumtimi dhe inovacioni, politika digjitale, arsimit dhe aftësitë dhe natyrisht, të rinjtë. Ky Plan Veprimi duhet gjithashtu të ketë një dimension të fortë të jashtëm pasi Bashkimi Evropian duhet gjithashtu të marrë përgjegjësi globale dhe të përfshijë partnerët në të gjithë dhe përtej kufijve të BE. Plani i Veprimit duhet të jetë në përputhje me [Konventën Faro mbi Vlerën e Trashëgimisë Kulturore për Shoqërinë](#) dhe [Strategjinë e fundit të Trashëgimisë Europiane për shekullin 21 të Këshillit të Europës](#), dhe me [Agjendën e OKB-së 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm](#).

VEPRIMI 2 NJOHJA E TRASHËGIMISË SI PRIORITET PËR POLITIKAT DHE FINANCIJIMIN EUROPIAN

Në mbështetje të Planit të Veprimit European për Trashëgiminë Kulturore, u bëjmë thirrje institucioneve të BE-së që të njohin plotësisht trashëgiminë kulturore si një prioritet strategjik në [programet e ardhshme të politikave](#) dhe [kuadrin e ri shumëvjeçar financiar të BE-së \(2021–2027\)](#). Kjo do të kontribuojë në investimin shumë të nevojshëm në kapitalin njerëzor dhe kulturor të Europës dhe në promovimin e vlerave të Europës. Në të njëjtën kohë, ne të gjithë angazhohemi të vazhdojmë të ndërtojmë vetëdijen për [vlerat dhe përfitimet e shumëfishta](#) të trashëgimisë kulturore për Europën. Kjo është veçanërisht e rëndësishme duke patur parasysh zgjedhjet e ardhshme të Parlamentit European në Maj 2019, dhe emërimit të Komisionit të ri European.

VEPRIMI 3 NDËRLIDHJA LOKALES, KOMBËTARES DHE EUROPIANES

Nivelet e ndryshme të qeverisjes janë çelësi për të lëshuar potencialin e plotë të trashëgimisë kulturore si një burim strategjik për shoqërinë, ekonominë, kulturën dhe mjedisin. Prandaj, i bëjmë thirrje të gjithë Shteteve, Rajoneve dhe Qyteteve në Europë që të vazhdojnë të zhvillojnë politika dhe plane veprimi gjithëpërfshirëse dhe ambicioze për trashëgiminë kulturore. Ne gjithashtu i nxisim ata që të rrisin dialogun dhe bashkëpunimin me organizatat relevante Europiane dhe ndërkombëtare, si dhe me shoqërinë civile. Duke siguruar kështu që politikat dhe planet e veprimit të miratuara nga nivelet e ndryshme të qeverisjes – nga ato lokale, kombëtare në ato europiane – plotësojnë njëra tjetrën dhe janë koherente.

VEPRIMI 4 RUAJTJA DHE TRANSMETIMI I TË PAZËVENDËSUESHMEN

Trashëgimia kulturore është unike dhe e pazëvendësueshme. Megjithatë, shpesh është e pambrojtur dhe madje e rrezikuar. Prandaj, është detyra jonë kolektive të ruajmë këtë thesar në mënyrë që ta transmetojmë atë për kënaqësi të mëtejshme dhe (ri) përdorim për gjeneratat e ardhshme. Ne duhet të shtojmë burimet e nevojshme njerëzore dhe financiare dhe të investojmë në aftësitë dhe ngritjen e kapaciteteve në mënyrë që të sigurojmë ruajtjen, zhvillimin dhe transmetimin e duhur të trashëgimisë sonë, si fizikisht dhe digjitalisht. Në këtë proces duhet të përfshijmë plotësisht universitetet dhe komunitetin hulumtues, të zhvillojmë modele inovative të biznesit dhe të nxisim sinergjitë krijuese midis trashëgimisë dhe arteve. Ne gjithashtu duhet të njohim vlerën e shprehjeve të paprekshme të trashëgimisë sonë, të cilat vazhdimisht evoluojnë dhe pasurojnë shoqërinë dhe mjedisin jetësor.

VEPRIMI 5 INVESTIMI NË RIGJENERIMI BAZUAR TEK TRASHËGIMIA

Ne duhet të sigurojmë dhe të mundësojmë investime adekuate, publike dhe private, në rigjenerimin e lagjeve, qyteteve dhe fshatrave bazuar tek trashëgimia në mënyrë kreative, inovative dhe adaptive; i frymëzuar nga parimet e cilësisë së lartë „Baukultur”, siç është formuluar në [Deklaratën e Davosit](#) e miratuar në fillim d Vitit European të Trashëgimisë Kulturore; dhe e pasuruar me pjesëmarrjen aktive të qytetarëve dhe komuniteteve të tyre dhe organizatave të shoqërisë civile. Në këtë kontekst, ne mirëpresim ndërveprimin krijues dhe respektues midis mbrojtjes së trashëgimisë së ndërtuar dhe kontributeve bashkëkohore në mjedisin tonë të ndërtuar, të cilat kontribuojnë në trashëgiminë e nesërme.

VEPRIMI 6 PROMOVIMI NJOHURIVE MË TË MIRA DHE KUPTIMSHMËRISË MË TË THELLË

Trashëgimia kulturore duhet t'u jepet një rëndësi shumë më e madhe në aktivitetet arsimore – si formale dhe joformale – për të gjitha grup-moshat. Kjo do të nxisë angazhim më të fortë publik për ruajtjen dhe transmetimin e trashëgimisë sonë kulturore. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet edukimit të historisë dhe interpretimit të trashëgimisë të vendosur në një kontekst më të gjerë të së kaluarës, të tashmes dhe të së ardhmes së Europës. Kjo do t'i pajisi qytetarët e Europës dhe sidomos fëmijët tanë dhe të rinjtë, me mjetet e nevojshme për të fituar një kuptim më të thellë të takimeve dhe shkëmbimeve të vazhdueshme brenda Europës, si dhe midis Europës dhe kulturave të tjera të botës. Të gjitha këto aktivitete do të ndihmojnë në ndërtimin e marrëdhënieve me respekt reciprok dhe më kuptimplota mes njerëzve dhe vendeve ku ata jetojnë, punojnë ose udhëtojnë. Kjo gjithashtu do të lehtësojë një mirëkuptim, respekt dhe përfshirje më të mirë të banorëve të rinj në Europë.

VEPRIMI 7 NDËRTIMI MBI MOMENTUMIN

Viti European i Trashëgimisë Kulturore ka forcuar vullin e politikave dhe mobilizimin e gjerë për trashëgimisë kulturore në Europë. Ne tani duhet të konsolidojmë dhe përmirësojmë më tej sinergjitë midis gamës më të gjerë të mundshme të palëve publike dhe private duke përfshirë organizatat relevante europiane dhe ndërkombëtare dhe shoqërinë civile. Për të arritur këtë, ne duhet të gjejmë një formulë adekuate për një platformë më të përhershme për mbledhjen e njohurive, ngritjen e kapaciteteve dhe koordinimin e avokimit për trashëgiminë kulturore në Europë.

Berlin, 22 Qershor 2018

Thirrja e Berlinit mund të nënshkruhet online në faqen e Europa Nostra:
www.europanostra.org/berlin-call-action

